



REPubLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT  
DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Nr.....Prot

Datë...../...../2023

RAPORTI

I MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT

Periudha e raportimit: JANAR – DHJETOR 2022

Në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.9, dt.06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” si dhe të Udhëzimit nr. 22 datë 20.03.2018. “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit për Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, ligjit nr.115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit për periudhën Janar – Dhjetor 2022 është me kod 1011237 dhe programi 09770 “Kërkimi Shkencor”.

Gjatë vitit 2022, përdorimi i fondeve buxhetore është bazuar në respektimin korrekt të planit të buxhetit të vitit 2022 të miratuar, sipas artikujve, kapitujve në lidhje me pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, shpenzimet operative, granteve për financimin e projekteve , investimeve, duke siguruar një menaxhim dhe përdorim të fondeve buxhetore me transparencë, eficiencë dhe efektivitet të plotë.

**Buxheti për shpenzimet korrente viti 2022**

Për AKKSHI-në buxheti i alokuar për vitin 2022, në muajin janar të vitit 2022, është **132,240,000 (Njëqindetridhjetëedymiljon e dyqindedyzetëmijë) lekë** me shkresën nr.7403/3, datë 10.01.2022 të MAS

Me shkresën me nr. prot.3449/1, datë 28.02.2022, dërgohet nga MFE granti i mbartur për bursat CEEPUS në shumën 412.142 lekë.

Me shkresën me nr. prot.3082/2, datë 28.02.2022, dërgohet detajimi i grantit për shpërndarjen e bursave CEEPUS në shumën 1.200.000 lekë, si pakësim i zërit 604 (91106AD) “konferenca e seminare”

Me shkresën nr. prot. 2179/1, datë 28.02.2022, dërgohet shpërndarja e grantit për projektet fituese Shqipëri –Austri faza II, miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimin nr.2, datë 04.02.2022, si pakësim në llogarinë 604 (91106AB) në shumën 4.312.500 lekë.

Me shkresën nr. prot.5039/1, datë 28.03.2022 të MFE , dërgohet transferim fondi për kryerjen e pagesës së kuotave ndërkombëtare (605) në shumën 600.000 lekë **duke pakësuar zërin 604 (91106AB)**”Financim i programeve Kombëtare e Ndërkombëtare të Kërkimit Shkencor.

Me shkresën nr.prot.4934/141, datë 11.04.2022, të MFE ”Mbi zbatimin e Aktit Normativ nr.3, datë 12.03.2022”pakësohet fondi i pagave dhe sigurimeve shoqerore përkatësisht 433.500 lekë.

Me shkresën e MFE nr. prot. 12448/1, datë 29.06.2022, dërgohet shpërndarja e grantit për projektet fituese Shqipëri- Kosovë Faza e II, miratuar nga Bordi i Administrimit me vendimin nr. 2, datë 03.02.2021 në shumën 3.218.000 lekë.

Me shkresën e MFE nr.prot. 15331/1, datë 18.08.2022, dërgohet shpërndarja e grantit për projektet fituese PKKZH në shumën 42.375.248 lekë.

Me shkresën e MFE nr.17372/1, datë 26.09.2022, dërgohet granti për projekte fituese PKKZH në shumën 17.436.556 lekë.

Me shkresën e MFE nr. 22635/1, datë 16.12.2022, dërgohet detajimi i grantit për projekte të bashkëpunimit dypalësh Shqipëri-Austri dhe Shqipëri –Turqi në shumat respektive 8.489.560 lekë dhe 7.512.069 lekë.

### **Buxheti për shpenzimet kapitale viti 2022**

Me shkresën nr.prot. 482/5, datë 15.03.2022 të MASR, dërgohet buxheti për shpenzimet kapitale në shumën **185.097.306 (Njëqindetëdhjetëepesëmiljon e nëntëdhjetëeshtatë mijë e treqindëgjashtë)** lekë. Kjo shumë duhet të shpërndahet për projektet e infrastrukturës për vitin 2022.

Nga Dega e Thesarit Tiranë u informuar që në muajin prill nga MAS është pakësuar shuma 684.007 lekë ,por ne nuk na kanë njoftuar me shkresë.

Me shkresën e MFE nr.prot.7638/1, datë 10.05.2022, kemi shpërndarje granti për projektet e infrastrukturës në shumën **106.045.688 lekë për 10 projekte**. Vendimet e Bordit të Administrimit 2 dhe 3 , datë 06.04.2022, janë për 14 projekte. MAS ka shpërndarë me fondet e saj grantin për 4 projekte pa dijeninë e AKKSHI-së.

Me shkresën e MFE nr. prot.7370/1, datë 04.05.2022, kemi pakësim të fondit të investimeve me shkresën e MAS në shumën 1.379.380 lekë.

Nga Dega e Thesarit Tiranë gjate rakordimeve kemi një pakësim tjetër me iniciativën e MAS pa na njoftuar me shkresë në shumën 10.000.000 lekë.

Në muajin qershor me shkresën e MFE nr.prot.9174/1, datë 13.06.2022 , kemi një pakësim tjetër të fondit për investime sipas shkresës së MAS në shumën 1.937.552 lekë.

Në muajin korrik është pakësuar shuma 3.527.263 lekë, pjesërisht për shumën 386.666 lekë është dërguar nga MAS shkresa nr.prot.13276/1, datë 25.07.2022 e MFE-së kemi njoftim dhe shkresë për shumën e mbetur 3.140.597 lekë nuk kemi shkresë zyrtare . Në mënyrë të përsëritur me email dhe shkresë zyrtare kemi kërkuar shkresat e pakësimeve, të cilat janë bërë nga MAS.

Me shkresën tonë nr. 842, datë 12.08.2022, është kërkuar shpërndarja e dytë për vitin 2022 e grantit të projekteve fituese të infrastrukturës në **shumën 53.439.998 lekë**.(Mas nuk na ka dërguar shkresën nga MFE).

Me aktin normativ nr. 17, datë 01.12.2022 kemi pakësim nga investimet shumën 6.806.852 lekë  
Për vitin 2022 totali i fondeve të infrastrukturës i shpërndarë është në shumën **159.485.686 lekë**.

Mbetja në fund të vitit 2022, pas pakësimeve nga MAS rezulton 264.026 lekë.

**Në kapitullin 02** (financim për Projektin MISTRAL) është shuma 100.000 lekë, për (Projektin me financim të huaj BLU AIR) shuma 100.000 lekë dhe për projektin U-SIA 500.000 lekë .

Me aktin normativ nr. 17, datë 01.12.2022 kemi shtim plani për Projektin BLU AIR 600.000 lekë dhe për projektin MISTRAL 500.000 lekë.

Buxheti total i AKKSHI-së për vitin 2022 është **317.037 (në mijë lekë)**

**Buxheti i rishikuar është në shumën 49.763 (në mijë lekë) .**

Emërtimi i Shpenzimeve	Buxheti v.2022 në 000/lekë	Buxheti v. 2022 i rishikuar në 000/lekë	Fakti Janar – Dhjetor 2022 ne 000/lekë
Shpenzime totale	317.037	49.763	39.644

**Realizimi i buxhetit për vitin 2022**

**Në 000/lekë**

Emërtimi i zërave të Buxhetit	Buxheti 2022	Buxheti i Rishikuar 2022	Fakti Janar – Dhjetor 2022	Në %
Paga	17.340	16.906	13.314	79%
Sigurime Shoqërore	2.820	2.750	2.226	81%

Mallra dhe Shërbime të Tjera	4.500	4.500	4.496	99.9%
Transferime korrente të brendshme	106.580	21.161	17.980	85%
Transferime korrente të huaja		600	600	100%
Transferta për buxhete familjare		170	170	100%
Projekte të infrastrukturës së Kërkimit Shkencor	185.097	264	0	0
Projekte të Kërkimit Shkencor Kap.02	700	1.800	0	0
Bursa CEEPUS		1.612	858	53,2%
<b>TOTALI</b>	<b>317.037</b>	<b>49.763</b>	<b>39.644</b>	<b>79.6%</b>

**Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore** (zërat 600+601) për periudhën janar- dhjetor 2022 janë realizuar në masën 79 % dhe 81% në zbatim të strukturës, organikës së miratuar me VKM dhe vendimit për pagat në administratën shtetërore. Struktura akoma nuk është plotësuar pasi në fakt janë 13 punonjës nga 19 punonjës që ka struktura në plan. Një punonjëse është me leje lindje. Kemi dhe një punonjëse me kontratë (sanitare) mbi numrin organik.

**Fondi për shpenzime në mallra dhe shërbime** (zëri 602), është realizuar në vlerën 4,496 në mijë lekë, në masën 99.9%. Shpenzimet operative janë për pagesën e rojeve operative , për shpenzime postare , organizimin e nje konference per kerkimin shkencor, për pagesat e Komisionit të Vlerësimit të Projekteve , për pagesat e anëtarëve të Bordit të Administrimit, për blerje kançeleri, udhëtime jashtë vendit etj.

**Fondi për transferime korrente të brendshme** në shumën 106.580 në mijë lekë.

Në bazë të vendimit nr.1, datë 04.02.2022, të BA –së ky fond është detajuar si më poshtë :

Financimi i projekteve ndërkombëtare	25.000.000 lekë
Financimi i PKKZH	79.780.000 lekë
Financimi i bursave CEEPUS	1.200.000 lekë
Financimi i kuotave ndërkombëtare	600.000 lekë

**Fakti**

- Për 19 projektet e bashkëpunimit Shqipëri – Austri faza II dhe Shqipëri- Kosovë është shpërndarë shuma 8.712.550 lekë.
- Për 19 projektet e bashkëpunimit Shqipëri – Austri dhe Shqipëri- Turqi është shpërndarë shuma 19.199.004 lekë. Bilateralët gjithsej 38 projekte.

- Për PKKZH për 46 projekte është shpërndarë shuma 71.010.598 lekë.  
Pra fondi i mbetur tek ( llogaria 604) 5.857.848 lekë

**Transferime korrente të huaja në shumën 600.000 mijë lekë.**

### **Fondi për bursat CEEPUS**

Fondi për pagesën e bursave CEEPUS është 1.612.142 lekë . Personat që kanë përfituar janë 18 dhe shuma e realizuar është 857.964 lekë , pra 53.2%.

**Projekte të infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në shumën 185.097.306 lekë.**

**106.045.688 lekë** u janë shpërndarë universiteteve sipas projekteve fituese.( 10 projekte).Nga MAS janë financuar 4 projekte te tjere, pra gjithsej 14 projekte.Në fund të muajit gusht janë financuar dhe 6 projekte të tjera të infrastrukturës,

Gjithsej për vitin 2022 është shpërndarë granti për **20 projekte fituese në shumën 159.485.686 lekë.**

**Në kapitullin 02 (financim për Projektin MISTRAL) është shuma 700.000 lekë , e cila nuk është shpenzuar .**

**Në kapitullin 02 (financim për Projektin BLU AIR) është shuma 600.000 lekë , por nuk është shpenzuar.**

**Në kapitullin 02 (financim për Projektin USIA) është shuma 500.000 lekë , por nuk është shpenzuar.**

**Të ardhurat jashtë limitit nga Hubs, Idealist , UNICEF,SEREN 5 etj. çelje 4.013 në mijë lekë. Shtuar për projektin UNICEF 3.078.000 lekë dhe SEREN 5 shuma 3.676.869,4 lekë. Në plan gjithsej 10.768.233.02 lekë**

-Projekti Idealist është mbyllur dhe është kthyer shuma 328.584 lekë.

-Nga projekti EURAXESS Hubs është shpenzuar 198.723 lekë , ende i pa mbyllur.

-Projekti UNICEF në shumën 3.078.000 lekë , shpenzur shuma 97.400 lekë .

-Projekti SEREN 5 në shumën 3.676.869.4 lekë . Nuk është shpenzuar për vitin 2022.

Pra nga të ardhurat jashtë limitit janë shpenzuar gjithsej **1.863.907.05 lekë** , mbetja për 2023 është **8.904.326 lekë** .

**Aktivitete të Organizuara nga Drejtoria e Programeve Ndërkombëtare**

## **SEKTORI I MARRËDHËNIEVE BILATERALE (DYPALËSHE)**

### **Janar- Dhjetor 2022**

Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale e ushtron veprimtarinë e tij në përputhje me ligjin Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në

Republikën e Shqipërisë”, Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 607, datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)” si dhe Udhëzimin përkatës, Nr. 1, datë 30.11.2017 të Ministrit të Arsimit, Sporteve dhe Rinisë “Për procedurën e paraqitjes, shqyrtimit dhe miratimit të projekteve që financohen në kuadrin e programeve të bashkëpunimit shkencor dhe teknologjik ndërmjet dy vendeve”.

Përgjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022 ky sektor u përqëndrua në realizimin e aktiviteteve që lidhen me promovimin e thirrjeve tekniko- shkencore bilaterale, hartimin e protokolleve të bashkëpunimit, çeljen e thirrjeve të reja, shqyrtimin e dosjeve të projekt-propozimeve nga ana teknike dhe financimin e projekteve të meparshme fituese.

## **Shqipëri- Austri**

Në kuadër të Marrëveshjes së Bashkëpunimit Shkencor e Teknologjik midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë nënshkruar në 2 Maj 2012, u financua faza e parë/viti I parë i projekteve fituese sipas Vendimit Nr. 2 të Bordit të Administrimit të AKKSHI, datë 30/05/2019, për "Miratimin e financimit të fazës së I-rë të projekteve fituese në fushën e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit, në kuadër të marrëveshjes bilaterale midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë". Pas mbarimit të kësaj faze dhe raportimeve vjetore lidhur me ecurinë e projekteve, AKKSHI- Sektori i Projekteve Bilaterale, u angazhua në plotësimin e dokumentacionit për nisjen e procedurës së financimit të fazës së dytë të këtyre projekteve.

Në vitin 2020 AKKSHI paraqiti kërkesën pranë Bordit të Administrimit për miratimin e financimit të fazës së dytë.

Bordi zhvilloi mbledhje më datë 30.07.2020, gjatë së cilës nuk mori vendim.

AKKSHI mbetet ende në pritje të vendimit të financimit nga ana e Bordit të Administrimit.

Në vitin 2022, AKKSHI parashtrroi sërish në BA- dokumentacionin për miratimin e financimit të fazës së dytë të projekteve mes Shqipërisë dhe Austrisë.

Financimi i këtyre projekteve u miratua nga Bordi i Administrimit të AKKSHI me Vendimin, Nr.2, i datës 04.02.2022, “Për Miratimin e Financimit të Fazës së Dytë të Projektet Fituese të Bashkëpunimit Tekniko- Shkencor ndërmjet Shqipërisë dhe Austrisë. Në datë 15. 02. 2022, AKKSHI- Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, dhe OeAD-GmbH, ICM - Centre for International Cooperation and Mobility, mbajtën takimin e Komisionit të Përbashkët, në përputhje dhe në zbatim të marrëveshjes ndërqeveritare, “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për Bashkëpunimin Shkencor dhe Teknologjik” e datës 2 maj 2012 dhe protokollit të përbashkët (dypalësh), të nënshkruar më datë 06.11.2018, Tiranë, sipas së cilës, u hap thirrja e radhës tekniko- shkencore dhe protokollit të bashkëpunimit, nënshkruar më 15. 02. 2022, në përputhje me të cilën, u përzgjedhën 10 – projektet fituese të thirrjes, pas vlerësimit individual në secilin shtet nga ekspertët vlerësues.

Në vijim të sa më sipër, nga thirrja tekniko- shkencore Shqipëri-Austri, hapur më datë 9.11. 2020 dhe mbyllur me datë 22.01.2021, u përfutuan 17 projekt- propozime.

Pas kontrollit teknik të dosjeve të projekt propozimeve të mbërritura pranë AKKSHI, u krye vlerësimi i tyre nga komisionet e ekspertëve vlerësues sipas fushave. Këto rezultate, në përputhje me marreveshjen dhe sa më sipër cituar në bazën ligjore, u shqyrtuan nga Komisioni i përbashkët , i cili më 15.02.2022 evidentoi 10- projekte fituese, të cilat do të paraqiten pranë BA për financim.

Komisioni i përbashkët u përbë nga:

Për Shqipërinë:

1. Znj. Mirela Muça, Kryetare e Delegacionit  
Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
2. Z. Robert Dumi  
Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
3. Znj. Evis Tasellari  
Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit
4. Z. Egest Gjokuataj  
Ministria e Arsimit dhe Sportit

Për Austrinë:

1. Mr. Christian Gollubits, Kryetar i Delegacionit  
Federal Ministry of Education, Science and Research
2. Mr. Dorian Taylor  
Federal Ministry of Education, Science and Research
3. Mrs. Isabella Scheibelreiter  
OeAD - Austria's Agency for Education and Internationalisation

Projektet fituese u zgjodhën në dakordësi të plotë me palën Austriake.

17- projekt propozimet grupohen në 5- nga fushat e kërkimit shkencor (I. Bujqësi, Ushqim, Bioteknologji; II. Biodiversiteti dhe Mjedisi; III. Shkenca Sociale dhe Albanologjike; IV. Sisteme dhe Teknologji Informacioni; V. Uji dhe Energjia).

Në respektim të protokollit të bashkëpunimit, në të cilin është dakordësuar për financimin e 10- projekteve, Komisioni i përbashkët mori vendimin për respektuar fushat prioritare të kërkimit shkencor duke shpërndarë fondin e thirrjes në projektet më të mira, sipas ponderimit të pikëve, për secilën fushë.

**Shënim:** Pala Shqiptare vlerëson përmes pikëve nga 0- 100 pikë; Pala Austriake vlerëson përmes pikëve nga 0- 50 pikë. Pala Austriake dyshemenë e financimit e ka duke nisur nga 35- pikë e më tej.

Financimi i këtyre projekteve u miratua nga Bordi i Administrimit të AKKSHI me Vendimin, Nr.1, i datës 23.11.2022, “Për Miratimin e Financimit të Projekteve në fushën e Kërkimit Shkencor, dhe Inovacionit, në kuader të Marreveshjes Dypaleshe me Austrinë, për periudhën 2022-2024”.

### **Aksionet COST- COST Action:**

Më tej gjatë periudhës Janar- Dhjetor 2022, në kontekstin e aksioneve COST Actions Sektori i Projekteve Bilaterale (Dypalëshe), është angazhuar në emërimin e aplikimeve të reja.

Në perjudhën Janar- Gusht 2022 janë emeruar rreth 30 kerkues, në cilesinë e pjesmarrësve në Komitetin Menaxhues (MC) të rreth 20- aksioneve të ndryshme.

Raporti i emërimeve respekton “Gender Gap”, duke shënuar një përfaqësim me 64% femra në total.

**Aktivitete te tjera:** *Konferenca Kombëtare- “Impakti i Kërkimit Shkencor në Ndërkombëtarizimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri”:*

Sipas Urdhërit Nr. 09. Datë, 22.02.2022, Sektori i Projekteve Dypalëshe, u angazhua për planifikimin dhe organizimin e konferencës. Konferenca u zhvillua më datë 28.03.2022, pranë Hotel Rogner. Në aktivitet morrën pjesë rreth 150- kerkues shkencorë; përfaqësues IAL-sh; drejtues institucionesh kërkimore dhe IAL-sh.

### **Shqipëri-Turqi**

Në kuadër të “Marrëveshjes për Bashkëpunimin në Shkencë dhe Teknologji ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit për Kërkimin Shkencor dhe Teknologjik të Turqisë (TUBITAK)”, datë 07.02.2007 dhe “Protokollit për Bashkëpunimin në Shkencë dhe Teknologji ndërmjet Këshillit të Kërkimeve Shkencore dhe Teknologjike të Turqisë (TÜBİTAK) dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës të Republikës së Shqipërisë”, nënshkruar në Ankara më 6 prill 2010, AKKSHI hapi thirrjen e re tekniko-shkencore për bashkëpunim bilateral ndërmjet këtyre dy vendeve, më datë 9 Dhjetor 2021-9 Mars 2022. Në përfundim të kësaj thirrjeje pranë AKKSHI u paraqitën 49 projekt-propozime, përkatësisht në fushat: I. Shkenca Sociale dhe Albanologjike; II. Biodiversitet dhe Mjedis; III. Agrikulturë, Ushqim dhe Bioteknologji; IV. Uji dhe Energjia; V. Shëndetësia; VI. Sisteme dhe Teknologji Informacioni.

Në vijim, pas vlerësimit nga ekspertët e komisioneve të fushave përkatëse dhe ballafaqimit të rezultateve me palën turke, të dhënat e gjeneruara paraqiten në tabelën si më poshtë vijon:

Në vijim, pas vlerësimit të projekteve nga ekspertët e komisioneve të fushave përkatëse dhe shqyrtimit të rezultateve të palës turke, *na eshte kerkuar pas komunikimit zyrtar nga keta te fundit qe te merret parasysh vendimi i Komitetit Ekzekutiv të TUBITAK, dhe te behet perzgjedhja e 9 projekteve.*

Financimi i këtyre projekteve u miratua nga Bordi i Administrimit të AKKSHI me Vendimin, Nr.2, i datës 23.11.2022, “Për Miratimin e Financimit të Projekteve ne fushen e Kerkimit Shkencor, dhe inovacionit, ne kuader te Marreveshjes Dypaleshe me Turqine, per periudhen 2022-2024”.



## **Shqipëri-Kosovë:**

Në vazhdim të detyrave funksionale Sektori i Projekteve Bilaterale dhe në zbatim të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës për bashkëpunimin në fushën e arsimit dhe shkencës, nënshkruar më 8.03.2010, hyrë në fuqi më datë 1.12.2011, miratuar me VKM Nr. 265 datë 21.04.2010, “Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës, për bashkëpunimin në fushat e arsimit dhe të shkencës”, u hap thirrja tekniko-shkencore më datë 15.05.2019 dhe u mbyll në datë 15.10.2019.

Më tej, në zbatim të Udhëzimit Nr. 1 Prot., datë 30.11.2017 “Për Procedurën e Paraqitjes, Shqyrtimit, Miratimit dhe Raportimit të Projekteve që Financohen në Kuadrin e Programeve të Bashkëpunimit Shkencor dhe Teknologjik Ndërmjet dy Vendeve” dhe në zbatim të Vendimit Nr. 2 datë 03.02.2021 “Për Miratimin e financimit të projekteve fituese në fushën e Kërkimit Shkencor, Teknologjisë dhe Inovacionit, në kuadër të Marrëveshjes bilaterale midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës”, janë gjeneruar dokumentat e nevojshëm për Sektorin e Financës në koordinim me vendimmarrjen e drejtuesit të institucionit, për disbursim të Fazës së Dytë të financimit të projekteve fituese.

Në vijim, në Qershor 2022, u realizua procedura e financimit të vitit të dytë të zbatimit të projekteve bilaterale të kësaj thirrjeje, procedurë e cila u krye pjesërisht nga AKKSHI dhe pjesërisht nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

## **Shqipëri- Itali:**

Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjale të administratës shtetërore dhe enteve publike”; bazuar në Programin e Bashkëpunimit në kuadër të Marrëveshjes për Bashkëpunim Shkencor ndërmjet Këshillit Kombëtar të Kërkimit të Italisë dhe Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë më datë 19.05.2017 si dhe të VKM Nr. 607 datë 31.08.2016 “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)” dhe Urdhërit nr.10 datë 15.01.2021, “Për ngritjen e Bordit të Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI)”,

Bordi i Administrimit të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI) me ane të vendimit nr.4, datë 02.08.2022 vendosi miratimin i hapjes së thirrjes së rradhës tekniko- shkencore, në kuadër të marrëveshjes bilaterale midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Italisë (CNR- Centro Nazionale di Ricerca). Afati perfundimtar i dorezimit të projekt-propozimeve u vendos deri në 30.09.2022 dhe për arsye teknike u shty deri më 07.11.2022.

## Drejtoria e Programeve Kombëtare

### Sektori i Programeve Kombëtare ka realizuar:

1. Ndjekja e ecurisë së projekteve të financuara në kuadër të PKKZH.
2. Përgatitja e relacionit mbi projektet e financuara PKKZH.
3. Përgatitja dhe shpallja e Thirrjes për aplikim për ekspertët e komisioneve të vlerësimit të projekteve.
4. Mbyllja e thirrjes dhe mbledhja e aplikimeve të depozituara.
5. Përgatitja e databazës me të dhënat e aplikantëve.
6. Përgatitja e dokumentacionit për BA.
7. Shpallja e Thirrjes për aplikim me projekte në kuadër të PKKZH 2022-2023.
8. Organizimi i ditëve informative mbi aplikimin me Projekte Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit.
9. Shqyrtimi formal i projekt-propozimeve të depozituara në AKKSHI.
10. Organizimi i procesit të vlerësimit të PKKZH 2022-2023.
11. Përgatitja e statistikave dhe të dhënave për projekt-propozimet e depozituara në AKKSHI.
12. Ndjekja e procesit të financimit të PKKZH 2022-2023.
13. Monitorimi i projekteve të financuara në kuadër të PKKZH.
14. Raportime periodike (me shkrim) në kuadër të informacioneve që kërkohen për integrimin.
15. Pjesëmarrje dhe kontribute, në kuadër të bashkëpunimeve ndër-institucionale dhe ndërkombëtare.
16. Pjesëmarrje dhe kontribute në takime pune/workshop-e/konferenca online organizuar nga institucione vendase dhe të EU.
17. Kërkim dhe mbledhje të dhënash lidhur me modelet e sistemit të kërkimit shkencor në rajon dhe EU.
18. Pjesëmarrje në webinar /sesione trajnimi dhe plotësimi i dokumentit "Qualitative Assessment Questionnaire "Competitiveness in South East Europe: A Policy Outlook 2021, Science, Technology and Innovation Dimension".
19. Pjesëmarrje në webinare//sesione trajnimi dhe kontribut në kuadër të nëngrupeve teknike të punës për plotësimin e "LGA (Screening list) Chapter 25: Science and Research".
20. Shpërndarja e thirrjeve dhe njoftimeve të reja Horizon Europe lidhur me infrastrukturën e kërkimit shkencor në rolin e NCP.
21. Implementimi i projektit Erasmus+ USIA;
22. Menaxhimi dhe popullimi i web dhe fb zyrtar të AKKSHI me lajme, njoftime, veprimtari.

### Sektori i Teknologjisë dhe Inovacionit ka realizuar:

1. Mbledhja e raportimeve nga IAL-të për ecurinë e relazimit të procedurave të projekteve të PIKSH 2021;
2. Përgatitja e relacionit mbi statusin e realizimit të projekteve të financuara të Infrastrukturës së Kërkimit Shkencor në 2021;
3. Përgatitja e të gjithë informacionit dhe dokumentacionit të duhur për financimin e

Në përfundim të kësaj thirrjeje pranë AKKSHI u paraqitën gjithsej 30 projekt-propozime, ku pas shqyrtimit teknik dhe dakordësimit me palen italiane u vendos që të vazhdojnë konkurrimin 17 projekt-propozime.

Gjithashtu pas dakordësimit me palën italiane, u vendos që vazhdimi i aktiviteteve të thirrjes së mëparshme(2021) midis Shqipërisë dhe Italisë (CNR) të përfundoj në Maj 2023.

## **Pregatitja e dokumentave për financim dhe disbursim(Ekspertet Vleresues) dhe Raportet Vjetore:**

### **Ekspertet Vleresues:**

Në kuadër të sa më lart, janë dërguar dhe dokumentat e nevojshëm për disbursimin e ekspertëve vlerësues, të cilët janë angazhuar për vlerësimin e projekt- propozimeve.

Pagesa e ekspertëve u realizua në përputhje me Vendimin Nr. 4 datë 30.11.2017 “Për Zëvendësimin dhe Miratimin e Ekspertëve të rinj të Komisioneve të Vlerësimit të Programeve Kombëtare të Kërkimit dhe Zhvillimit dhe të Programeve Dypalëshe, në programet ku kanë dhënë dorëheqjen Ekspertët e mëparshëm të Komisioneve të miratuara në vitin 2015” dhe VKM Nr. 567, datë 23.10.1995, “Për shpërblimin e Këshillave, Komisioneve dhe Ekspertizave të Veprimtarisë Shkencore e Teknologjike”.

Në të njetjën logjikë është kryer dhe përpilimi i dokumentacionit dhe pagesa e Ekspertëve Vlerësues, të cilët kanë kryer detyrën e tyre funksionale, lidhur me projekt- propozimet e thirrjes Shqipëri- Austri dhe Shqipëri-Turqi.

Ekspertët Vlerësues janë në përputhje me Vendimin e Bordit të Administrimit të AKKSHI, Nr. 1, Datë 18.06.2021 “Për Miratimin e Komisioneve të Vlerësimit teknik të projekteve në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit”

### **Raportet Vjetore:**

Në zbatim Miratuar me Vendimin Nr 3 datë 30.11.2017 të Bordit të Administrimit të AKKSHI, çdo drejtues projekti është i detyruar të bëjë raportin e ecures së projektit në fund të çdo viti deri në përfundimin e projektit, qoftë ky një, dy apo tre vjeçar. Raporti vjetor bëhet për çdo projekt në veçanti dhe i paraqitet organit financues në dyjavorin e parë të muajit Janar të vitit në vazhdim.

Spektori i Projekteve Bilaterale në kuadër të thirrjeve bilaterale Shqipëri-Kosove(2020) dhe Shqipëri-Itali(2021) është duke kryer kontrollin teknik të raporteve vjetore të këtyre projekteve fituese.

## **SEKTORI I MARRËDHËNIEVE MULTILATERALE**

**Aktivitetet, ditë informative dhe trajnime të organizuara nga sektori i Marrëdhënieve Multilaterale (AKKSHI) mbi Programet Europiane për Kërkimin Shkencor dhe Inovacionin në kuadër të Horizon Europe, Euraxess, COST dhe Gender Equality Plans (GEP):**

**Për periudhën Janar-Dhjetor 2022.**

- 18 - 19 /01/ 2022 Info-Days for the EU Missions
- 20 /01/ 2022 Cluster 3, BRIDGE2HE, Spotlight on Missions
- 24/01/ 2022 Horizon Europe Matchmaking Event on Digital and Emerging Technologies and Human-centred
- 26 January 2022 Horizon Europe webinar on Grant Agreement Preparation
- 02 /02 /2022 Training Day Horizon Europe – Euraxess Hubs at University of Sports Tirana
- 03 /02 /2022 Webinar, Horizon Europe Workshop on the European Partnerships
- 08 /02 /2022 EURAXESS Hubs WP3 - Mentoring matching procedure Q&A
- 10 /02 /2022 Eureka Western Balkans WG
- 10 /02 /2022 Euraxess Hubs REBECA by EURAXESS Mentoring. Kick-off Meeting - EVENING SESSION
- 11 /02/ 2022 Euraxess Hubs REBECA by EURAXESS Mentoring. Kick-off Meeting - MORNING SESSION
- 16/ 02 /2022 Training Day How to Prepare a Successful Proposal in Horizon Europe 2021 – 2027 Municipality (Day 1).
- 17/ 02 /2022 Training Day How to Prepare a Successful Proposal in Horizon Europe 2021 – 2027 Municipality (Day 2).
- 21/02/2022 - MISTRAL SC and TC meeting
- 02/03/2022 - Euraxess Hubs meeting
- 9-10/03/2022 - BLUEAIR partners meeting Podgorica, Montenegro
- 18/03/2022 - Euraxess Top IV ERA Talent Platform Coordinator Candidates presentations
- 18/03/2022 -Euraxess Hubs meeting – Matchmaking Event
- 21/03/2022 -Mistral SC and TC meeting
- 28/03/2022 -Konferenca Kombëtare e Kërkimit Shkencor 2022
- 30/03/2022 - Western Balkans Steering Platform Meeting on R&I
- 05/04/2022 - Eureka Danube 2022 call - Webinar for applicants
- 07/04/2022 – MISTRAL Sc Meeting
- 08/04/2022 - MISTRAL Final Event Roma
- 11/04/2022 – Info-Day NASRI Office (University of Sports Tirana)

- 14/04/2022 - Policy answers Kick of Meeting
- 15/04/2022 - Policy answers Kick of Meeting
- 26 /04/ 2022-Euraxess Hubs and Horizon Europe Training Days Faculty of Economics, University of Tirana
- 28/04/2022 -Bridge2HE Spotlight on European Missions 2.0
- 19/07/2022 “Project Presentation and Regional Cross-Fertilization Workshops in Albania”
- 19/07/2022,Project Presentation and Regional Cross-Fertilization Workshops in Albania- Blueair(Interreg Adrion)
- 16/09/2022- ne ambjentet e AKKSHI u zhvillua takimi informues me pjesemarrës të ardhur nga Fakulteti i Bioteknologjise dhe Ushqimit nga Universiteti Bujqësor i Tiranës ku u diskutua mbi projektet Widening dhe programin e tij të punës. Po ashtu në këto aktivitete u prezantua programi Horizon Europe,COST, platforma Euraxess dhe Eureka, gjithashtu u theksua rëndësia e tematikës së GEP( Gender equality Plan).
- 30/09/2022 - CSL me iniciativën e saj dhe në koordinim me Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar(DPAP) dhe Agjencinë Kombëtare të Kerkimit Shkencor dhe Inovacionit(AKKSHI) organizoi disa aktivitete ndërgjegjësuese gjimnazet “Sami Frasheri” dhe “Ismail Qemali” në Tiranë në kuadër të iniciativës të BE, Dita Europiane e Kerkimit Shkencor, që zhvillohet të Premten e fundit të çdo Shtatori. ([www.csl.edu.al/news/dita-europiane-e-kerkimit-shkencor/](http://www.csl.edu.al/news/dita-europiane-e-kerkimit-shkencor/))
- 10/10/2022, u zhvillua takimi Informues/Orientues i rradhës pranë Ministrisë së Arsimit për të koordinuar punët e Kapitullit 25.
- 17/10/2022, u zhvillua takimi Informues/orientues i rradhës pranë Ministrisë së Arsimit për të koordinuar punët e Kapitullit 25.
- 20/10/2022 , takim informues online mbi projektin SpaceMED (IPA)
- 26/10/2022, konferenca Online Blueair
- 15/11/2022, Working Group on Industrial Development Meeting on CRM Regional Industrial and Innovation Area Green and Circular Economy Value Chains, Tirana ,Albania
- 21/11/2022, WB I&R Platform - 2nd online meeting - 21 Nov 2022@10:00, (Western Balkans Innovation & Research Platform’s 2nd ONLINE meeting to be held on 21 November 2022 @ 10.00 hrs)

- 21/11/2022, Bluair – Matchmaking events- Technical meeting
- 09/12/2022, Konference online(12:00-13:00) ne kuader te Policy Answer
- 09/12/2022, Takim Informues Hotel Tirana International- “Takim Teknik - Programi Interreg ADRION”(11:00- 13:30)
- 12/12/2022, takim informues prane zyrave te Drejtorise mbi Eureka,Horizon Europe,COST, Programet Kombetare dhe Bilaterale me perfaqesues nga SME
- 14/12/2022, takim online “BLUEAIR partner meeting” ,10:00-12:00
- 14/12/2022, MSCA-NET mentoring programme - 2nd virtual session, 10:00-12:00
- 15/12/2022, takim online, “SEREN5 2ND CONSORTIUM MEETING”, 10:30-12:30
- 19/12/2022, konferenca online, “Horizon Europe - virtual ERA Brokerage Event 2023”, 9:00-13:00, 14:00-18:00
- 19/12/2022, takim online, “Blueair- Second wave - event budget”, 9.30- 10:30
- 23/12/2022, “Workshop” te Hotel Tirana International mbi projektet Adrion(Interreg), 8.30-14.00

### **Aktivitete te tjera:**

- Gjithashtu gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022, u dërguan tek databaza e kërkuesve shkencor, thirrjet e hapura, programet e punës, webinarë, trajnime, konferenca të ndryshme shkencore dhe mundesi te reja te shpallura në kuadër të programeve të Horizon Europe, MSCA, etj.

-Po ashtu gjatë kësaj periudhe është bërë: raportimi i projekteve të ndryshme, pregatitja dhe nënshkrimi i Marrëveshjes së Grantit në kuadër të projekteve, përdorimi i Funding and Tenders Portal, publikimi i vendeve të punës për stafet akademike tek Portali Euraxess Albania etj.

- Kërkuesit Shkencor, Stafet Akademike, po asistohen on-line dhe off line në lidhje me pyetje apo paqartësi të ndryshme që lidhen me hapat e aplikimit në Horizon Europe, COST, Euraxess, pjesa e buxhetit, marrëveshjet e grantit, raportimet etj.

- Në kuadër të Kapitullit 25, Zgjerimin e Zonës Europiane të Kërkimit ERA, Implementimin e Strategjisë Kombëtare për Shkencën, Teknologjinë dhe Inovacionin 2017-2022 dhe Projektplanit

Kombëtar për Integrimin European 2021 – 2023, Sektori i Marrëdhënieve Bilaterale dhe Multilaterale jep kontribut të vazhdueshëm dhe po ndjek me vëmendje të vecantë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin prej tyre.

### **Projektet e Fituara:**

Sektori i Marrëdhënieve Multilaterale ka aplikuar dhe është partner fitues në disa projekte: Në këtë drejtim kemi filluar implementimin e Projekteve:

- **Titulli i Projektit:** Mediterranean Innovation Strategy for transnational activity of clusters and networks of the Blue Growth
- **Koordinatori i Projektit:** Emilia Romagna Region
- **Kohëzgjatja e Projektit:** 01/02/2018 – 31/01/2022
- **Project Nb:** NR. 2925
- 
- **Titulli i Projektit:** Blue Growth Smart Adriatic Ionian S3 BLUEAIR
- **Koordinatori i Projektit:** Area di Ricerca Scientifica e Tecnologica di Trieste –Area Science Park
- **Kohëzgjatja e Projektit:** 01.12.2020– 31.05.2023
- **Project Nb:** 1229
  
- **Titulli i Projektit:** Euraxess Top IV
- **Koordinatori i Projektit:** Ethniko Kentro Erevnas Kai Technologikis Anaptyxis (Certh)
- **Kohëzgjatja e Projektit:** 1 Shtator 2018 – 31 Gusht 2021
- **Kodi i Brendshëm i Referimit:** 786133 1.0 05/07/2018.
  
- **Titulli i Projektit:** Euraxess Hubs
- **Koordinatori i Projektit:** Bay Zoltan Alkalmazott Kutatasi Kozhasznu Nonprofit Kft. (Bzn)
- **Kohëzgjatja e Projektit:** 1 Shtator 2021 – 1 Shtator 2022
- **Kodi i Brendshëm i Referimit:** 101035541
  
- **Projekti:** HORIZON-WIDERA-2021-NCP-IBA
- **Type of Action:** HORIZON-CSA
- **Akronimi:** NCP\_WIDERA.NET
- **Current Phase:** Grant Management
- **Numri:** 101055286
- **Kohezgjatja:** 36 muaj
- **GA based on the:** HE MGA — Multi & Mono - 1.null
- **Data e fillimit:** 01 Prill 2022

- **Kostoja e parashikuar e projektit: €8,000,000.00**
- **Kontributi kerkuar nga BE-ja: €8,000,000.00**

- **Projekti: HORIZON-CL3-2021-SSRI-01**
- **Type of Action: HORIZON-CSA**
- **Akronimi: SEREN5**
- **Current Phase: Grant Management**
- **Numri: 101073472**
- **Kohezagjatja: 36 muaj**
- **GA based on the: HE MGA — Multi & Mono - 1.null**
- **Data e fillimit: 01 Shtator 2022**
- **Kostoja e parashikuar e projektit: €2,374,666.25**
- **Kontributi kerkuar nga BE-ja: €2,374,666.00**

- **Projekti: HORIZON-WIDERA-2021-ACCESS-06**
- **Type of Action: HORIZON-CSA**
- **Akronimi: POLICY ANSWERS**
- **Current Phase: Grant Management**
- **Numri: 101058873**
- **Kohezagjatja: 48 muaj**
- **Data e fillimit: 01 Mars 2022**
- **Kostoja e parashikuar e projektit: €4,993,109.00**
- **Kontributi kerkuar nga BE-ja: €4,993,109.00**

- **Projekti: HORIZON-CL6-2021-BIODIV-02**
- **Type of Action: HORIZON-COFUND**
- **Akronimi: Biodiversa-plus**
- **Current Phase: Grant Management**
- **Numri: 101052342**
- **Kohezagjatja: 84 muaj**
- **Data e fillimit: 01 Tetor 2021**
- **Kostoja e parashikuar e projektit: €137,675,323.00**
- **Kontributi kerkuar nga BE-ja: €40,000,000.00**



- projekteve nga Bordi i Administrimit të AKKSHI;
4. Informimi në rrugë shkresore dhe elektronike i IAL për projektet fituese;
  5. Ndjekja e procesit të realizimit të projekteve PIKSH dhe informimi për statusin e realizimit të tyre.
  6. Monitorimi i projekteve të financuara në kuadër të PKKZH.
  7. Pjesëmarrje dhe kontribute, në kuadër të bashkëpunimeve ndërinstitucionale dhe ndërkombëtare.
  8. Raportime periodike në kuadër të informacioneve që kërkohen për integrimin dhe të tjera;
  9. Pjesëmarrje dhe kontribute në takime të grupeve të punës/workshop-e/konferenca online organizuar nga institucione vendase dhe të EU.
  10. Implementimi i projektit Erasmus+ USIA

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Mirela MUCA

